

DHIMITËR S. SHUTERIQI

SHKRIMTARËT DHE DREJTSHKRIMI

I gjithë populli, të gjitha shtresat e shoqërisë sonë socialiste, po edhe gjithë shqiptarët ngado janë, e kanë pritur me një interes të jashtëzakonshëm këtë Kongres të drejtshkrimit të gjuhës sonë të përbashkët letrare, dhe kështu i presin edhe vendimet e tij.

Interesi për gjuhën dhe kulturën në gjuhën kombëtare, që zgjuan e ushqyen me aq zjarr Veqilharxhi e Kristoforidhi, De Rada e Kamarda, Naimi e Samiu, Vaso Pasha e Luigj Gurakuqi me plot rilindës të tjerë, la mbresë të pashlyeshme në jetën politike dhe veçanërisht kulturele të popullit tonë. I kërcënuar vazhdimisht në vetë qenjen e tij, përmes rrethanave më të egra historike, shqiptari, këto njëqind e sa vjet, në këtë periudhë të formimit e përforcimit të kombit të tij, ka qenë shumë i ndjeshëm e përherë i interesuar për çështjen e gjuhës. Po në ditët tona, përmbysja epokale që ngjau në Shqipëri, u bë faktor vendimtar i përforcimit të plotë të kombit dhe problemin e gjuhës e të zhvillimit të shpejtë të saj, për një normë të vetme letrare, e vuri menjëherë në rend të ditës e nuk vonoi ta zgjidhë.

Përmenda më lart disa emra, midis të cilëve edhe disa nga shkrimtarët më të shquar të Rilindjes. Mund t'u kisha shtuar atyre edhe të tjerë, që patën pasionin e madh të shkrimit të shqipes dhe që lojtën rol në këtë fushë, si Mjeda e Noli, Asdreni e Lasgushi, pa harruar, më këtej, plejadën e shkrimtarëve që nga Shevqet Musaraj e Jakov Xoxa, gjer te Ismail Kadareja e Dritëro Agolli me shokë.

Edhe pse interesi i shkrimtarëve për çështjen e gjuhës nuk mund të ishte njëlloj prej njërit tek tjetri, ndihmesa e tyre për krijimin e normës së vetme letrare shqipe ishte, për një shumicë prej tyre e dukshme. Këta ishin përgjithësisht të vetëdijshëm për rolin e «fjalës së bukur» në krijimin e gjuhës sonë letrare të përbashkët. Ata kanë sjellë një shërbim të madh për pasurimin e gjuhës letrare me prurjet nga dialektet e të folmet, duke luajtur kështu rol, si në afrimin ndër-dialektor, ashtu edhe në krijimin e normës së vetme të shkrimit e të drejtshkrimit. Si përpunues të sintaksit e të stilit, si zgjedhës me shije të fjalës e të lokucionit, si krijues fjalësh e nuancash kuptimore, shkrimtarët kanë qenë në ballë të punës për gjuhën tonë letrare të përbashkët. Ende njihet pak e aspak, ende pak a aspak studjohet e përgjithësohet kjo ndihmesë nga shkenca jonë mbi gjuhën.

Dua të përmend këtu, se shkrimtarët tanë, veç rastesh të rralla, fill pas Luftës nacionalçlirimtare, nga cilido dialekt që vinin, u hodhën

me guxim nga ana e përpjekjes për afirmimin e një gjuhe të vetme letrare, të shkruar në fytyrën apo në bazën, si ta themi, të dialektit jugor. Ata që shkruanin në variantet letrare të Veriut, kuptohet se nuk e patën përherë të lehtë. Shkrimtarët, të cilët e ndjejnë gjuhën në tërë pejzat kur është fjala për të lënë një trajtë të shkruari për një tjetër, mundet, natyrshëm, të ngrenë edhe «gjembat». Po njerëzit tanë të letërsisë e çmuan shumë shpejt nevojën e një norme të vetme letrare shqipe. Ata e kuptuan kaq drejt se çasti vendimtar kishte çastisur për këtë, sa që, menjëherë, në masën dërmuese të tyre, e përqaftuan me entuziazëm çështjen e një gjuhe të vetme letrare, e cila u vu në përdorim nga administrata, shkolla, shtypi, radioja etj. Puna e paraardhësve aty çonte, dhe ne njerëzit e letërsisë, qemë të ndër-gjegjshëm për domosdonë historike dhe për detyrën që na dilte.

Gjuha letrare, përmes talenteve dhe veprave të ndryshme, përmes zhvillimit të mbarë gjinive, edhe të atyre që dje nuk kishin bërë sa duhet përpara, si drama dhe proza artistike, edhe të gjinive të reja, si ato të ekranit, ka pasur përfitime të mëdha, në çdo drejtim, në rrugën e pasurimit e të larmimit të saj, aq sa dhe në rrugën e njësimimit.

Është e kuptueshme që ky Kongres ngjall interesimin më të madh të forcave letrare dhe artistike. Shtoj edhe forcat artistike, sepse njerëzit e skenës e të ekranit i çon puna të rrojnë efektivisht me problemin e gjuhës. Sidoqoftë, më lejoni të sjell këtu një element autokritike.

Edhe pse shkrimtarët kanë dhënë një ndihmesë të dukshme në përcaktimin e normës drejtshkrimore, në botimet tona luhatjet kanë ekzistuar e vijojnë të ekzistojnë, ndonëse kanë vajtur drejt pakësimit. Kjo s'ka të bëjë vetëm me faktin se njësimi arrihet gradualisht, pra se është dashur kohë që të vimë në këtë njësim që kemi sot, po, do të thosha, se nuk ka pasur tek cilido një vëmendje të mjaftueshme dhe konstante ndaj gjuhës. Një tok normash, të cilat jeta mund të themi se i ka sanksionuar, nuk janë bërë ende sa duhet tonat. Luhatjet e mospajtimet kanë rrjedhur për arsye të «forcës së inercisë», të forcës së një tradite që mund të ishte kapërcyer prej këtij apo atij shkrimtari më lehtë se sa i është dukur për arsye të parapëlqimeve, shijeve, shprehive. Kur është fjala për artistët, mund të themi se përpjekja e një numri jo të vogël prej tyre, që të përvetësojnë gjuhën letrare dhe ta flasin atë qartë e saktë, shpesh ka lënë dhe lë për të dëshiruar, ndonjëherë dhe shumë.

Do të ndalem tani në një çështje, që mund të duket se qendron anash problemit që kemi përpara.

Jeta ka vërtetuar, gjetiu dhe tek ne, se, në fushën e letërsisë artistike, edhe pasi është krijuar një normë e përbashkët e gjuhës letrare, normë e cila qendron mbi dialektet, prapë se prapë, dialektet, apo dhe të folmet, për një arsye ose për një tjetër, sado rastësisht kanë vijuar të përdoren me shkrim. Është e njohur nga praktika se shkrimtari ka nevojë, herë pas here, t'i bëjë të flasin personazhet e tij në një dialekt të caktuar, kur kjo ndihmon për tipizimin dhe për të krijuar atmosferë. Është i njohur, në të kaluarën tonë letrare, fakti se e folmja e Tiranës ka shërbyer për efekte komiciteti. Kemi akoma ndonjë shkrimtar që nuk përdor normën e përbashkët letrare. Tani,

fenomeni që shkrimtarë, të cilët sapo marrin pendën, të përdorin norma të veçanta letrare apo dialektin, nuk haset. Kjo tregon se nuk ndjehet nevoja e përdorimit të normave të veçanta dhe e të shkruarit në dialekt, dhe kjo është shumë mirë; në këtë fazë të konsolidimit të gjuhës sonë letrare të përbashkët. Po prapë mund t'i lindë dëshira ndokujt të shprehet në dialekt, gjë që unë, për vete, nuk e quaj të rekomandueshme dhe të kohës. Në raste të tilla, normat e përbashkëta të drejtshkrimit nuk mund të ruhen plotësisht. Del kështu problemi i një përcaktimi më të mirë edhe të normave të veçanta dhe dialektale, që aty-këtu përdoren ose do të përdoren. Puna me ribotimin e shkrimtarëve të së kaluarës, sidomos për masat e gjera të lexuesve, e kërkon një kujdes të tillë dhe mjaft është bërë me rastin e ribotimit të disa prej tyre, që veprat të vihen sa më pranë drejtshkrimit të sotëm, duke i ndihmuar ato për të komunikuar sa më lehtë me lexuesin.

Unë bashkohem përgjithësisht me propozimet që na ka bërë pesë vjet më parë Komisioni i drejtshkrimit pranë ish-Institutit të historisë dhe gjuhësisë. Në se mund të kem ndonjë vërejtje, atë besoj se do ta kenë edhe të tjerë, të cilët s'kanë për të munguar ta formulojnë. Prandaj edhe nuk do të ndalem në vërejtje të tilla.

Dua së pari të bashkohem me mendimin që, në këtë Kongres, të arrijmë një njësim sa më të plotë drejtshkrimor që të jetë e mundur. Ndonjë «skrupul» prej gjuhëtari apo dhe shkrimtari të kapërcehet në mënyrë të guximshme. Gjuha e shkruar ka njohur një evoluim të madh e të shpejtë gjatë kësaj të katërte shekulli. Sigurisht është një përfundim i afrimit ndër-dialektor që tani shkruajmë *shkoja* dhe jo *shkonja*. Po më duket se edhe mjaft me vetëdashje e me vullnet të qartë kemi bërë, të paktën ne njerëzit e letërsisë, një zgjedhje të tillë, se nuk shoh që mund të na detyronte gjë, që doemos të zgjidhnim trajtën *shkoja*. Që të kemi vendosur trajtën *shtëpia* dhe jo *shtëpija*, sikundër shqiptohet, nuk duhej kaq një luhajtje e gjatë, se sa një vendim i shpejtë. Ndërsa veshi na çon menjëherë tek trajta *shtëpija*, ne vendosëm që syri të mos i bindet veshit. Janë edhe raste të tjera, në të cilat mëdyshja ekziston, po ku ne mund të marrim një vendim të prerë, pa u trembur se gjuha e shkruar nuk e ka thënë sa duhet fjalën e saj, apo se një pakicë njerëzish nuk do të jenë të atij mendimi. Dialektet tona kanë bashkëpunuar tani në mënyrë të mjaftueshme me shkrim. Kjo është mjaft për të na bindur edhe për rastet e mëdyshme të drejtshkrimit, që mund të diskutohen në këtë Kongres e për të cilat kujtoj se duhet të marrim një vendim të prerë.

Sigurisht, mendimi i shumicës, në mos i të gjithëve, them se është që vendimet e Kongresit të bëhen pa vonesë ligj e të respektohen nga të gjithë. Aktet solemne si ky, kërkojnë edhe zbatime të shpejta. Koha është krejtësisht në favor.

Një çështje e fundit.

Përhapja e normave të drejtshkrimit ndesh në disa vështirësi subjektive. Midis këtyre është së pari kujdesi ende i paktë i shumë njerëzve në të shkruar. Ai kujdes që, përgjithësisht, ekziston në botimet dhe në shtypin tonë, ndonse, edhe ato nuk janë pa të meta nga kjo anë, duket pak në shkrimet që afishohen (parrulla, tabela, reklama etj.), të cilat i hasim kudo. Puna e shkollës, që dhe ajo mbetet e pa-

mjaftueshme, nis e cenohet posa nxënësi del prej klasës. Nuk kemi një përpjekje vërtet të koordinuar që ta luftojmë anortografinë. Kjo përpjekje sot na kërkohet dhe besoj se mund të gjejmë të gjitha mënyrat e organizimit të saj, në shkollë e sidomos jashtë shkollës.

Ne jemi duke jetuar çastin më të rëndësishëm të historisë së gjer-tanishme të gjuhës sonë letrare. Ky është hapi i fundit i madh për njësimin sa më të plotë që asaj i lejohet të marrë në këtë ditë. Këtë s'e kërkoi rastësisht koha, as ja imponuam ne me përdhuni. Ishte krejt e natyrshme, dhe kjo nuk qe një nuhatje e thjeshtë, po një akt i vetë-dijshëm prej njohje realiste të gjendjes, që partia dhe shteti ynë ndihmoi me të madhe, menjëherë pas luftës, për vendosjen e normës së përbashkët letrare shqipe. Koha provoi edhe kundër një farë skepticizmi që ka ekzistuar, se kjo ishte rruga shkencërisht e drejtë dhe Kongresi ynë dëshmon fort për këtë.

Hapi që po bëjmë sot në fushën e drejtshkrimit, i jep fund etapës së madhe të këtij procesi. Tani hyjmë, në mënyrë edhe më të gjerë dhe me një ndihmë më efikase të shkencës, në një etapë të re zhvillimi të gjuhës. Paskëtaj gjuha jonë letrare do të zhvillohet mbi një bazë mjaft të arrirë të njësimin të gjithanshëm të saj. Nga ana tjetër, shqiptarët, të cilët dita me ditë po e rritin shumë kulturën e tyre, kujtdo dialekti që t'i përkasin, do të përpiqen që jo vetëm të shkruajnë, po edhe të flasin letrarisht. Kjo përpjekje është e domosdoshme për artistët, arësimitarët, nxënësit, njerëzit e radio-televizionit, po edhe për zyrtarët etj.

Le ta themi se ne bëjmë në këtë drejtim një punë ende të pamjaftueshme, brenda dhe jashtë shkollës. Një arësimitar që nuk u flet nxënësve në gjuhë letrare, e kryen keq detyrën e tij, një spiker që nuk u flet dëgjuesve në gjuhë letrare, e kryen gjithashtu keq detyrën e tij; kështu edhe aktori i teatrit apo i kinemasë. Ka ardhur dita të tregohemi më këmbëngulës e më pak tolerantë. Gjuha e përbashkët letrare nuk bëhet e masave dhe nuk shkon përpara vetëm me anë të shkrimit, po edhe me anë të folurit. Të shkruajmë *drejt*, po të flasim edhe *drejt*. Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme shoqërore ndaj zhvillimit të gjuhës.

Duke shprehur në këtë Kongres gëzimin e madh të njerëzve të letërsisë e të artit, që ja arritëm ditës kur po vendosim për normën sa më të njësuar të drejtshkrimit të shqipes letrare, më lejoni të sjell këtu premtimin e shkrimtarëve dhe artistëve tanë, që vendimet e këtij kuvendi historik të gjuhës, t'i vemë në jetë, ashtu siç e kërkon e mira e kulturës sonë kombëtare, e mira e popullit.